




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

Nga seanca e V (pestë) e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, mbajtur më 28.5.2012 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

- 2.1 Raporti financiar tre mujor Janar-Mars 2012,
- 2.2 Propozim Rregullorja për Shërbimet Publike Komunale,
- 2.3 Shqyrtimi i kërkesës për shfuqizimin e vendimit të miratuar nga KK-Gjilan, Nr.01.8367 të datës 09.07.2010 për ndalimin e shitjes të pronave publike nga AKP-ja,
- 2.4 Propozim vendimi për dhënien e pëlqimit për ndërrimin e një pjese të pronës komunale me një pjesë të pronës private të Lagja "Zabeli i Sahit Agës" ZK- Gjilan,
- 2.5 Rekomandim drejtuar MASHT-it për harmonizimin e Udhëzimit Administrativ Nr.10/2008 për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave, me LVL,
- 2.6 Ndarjen e bursave për master, për studentët që studiojnë në Itali (rasti i Alketa Spahiut),
- 2.7 Propozim vendimi për vazhdimin e mandatit anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në KRM "Higjiena",

3. Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 10.10 min

Kryesuesi i seancës;

- Izmi Zeka

Në punimet e seancës së V (pestë) morën pjesë:

- Anëtarët e Kuvendit
- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e drejtorive,
- Përfaqësuesit e OSB-së
- Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
- Mediet

Në fillim të seancës, kryesuesi i Kuvendit i përshëndeti të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe pjesëmarrësit e tjerë në sallë, duke i dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë gjatë kësaj kohe. I cili së pari, propozoi rendin e punës të cilin anëtarë e Kuvendit e kanë marrë me kohë. .

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës së pestë ishin të pranishëm 39 anëtarë të Kuvendit, kurse munguan: Selim Selimi dhe Enver Hajrullahu.

Pasi që në seancë pati kuorum për të vazhduar me punë, kryesuesi kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se a ka ndonjë vërejtje në rendin e punës?

Arben Mehmeti- sa i përket rendit të punës, përveç propozimeve tona që i kemi, ne e kemi edhe një vërejtje për juve kryesues si institucion i Komunës, sepse ka një kohë bukur të gjatë, në sallë të Kuvendit nuk është fotoja e Presidentit-es, i cili veprim nuk është në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Është mirë që nëpër institucione tona tash e tutje të vendoset fotoja e Presidentes.

E dyta urime për zgjedhjet preliminare në Ferizaj!

Lidhur me rendin e punës, ne kemi edhe nën të ndryshme disa pika, por i kemi edhe disa kërkesa të cilat i kemi paraqitur më herët si grup i LDK-së për të cilat ende nuk kemi marrë përgjigje. Gjithashtu të jetë rekomandim për drejtoritë përkatëse që të jenë të përgjegjshëm dhe të përgjigjen në afat ligjor.

Gjithashtu ne e kemi edhe një kërkesë të ju dhe kryetari i Komunës që të kërkohet nga Qeveria e Kosovës që të hiqet taksa e sigurimit për qytetarët e Kosovës Lindore, sepse kjo taksë po e dëmton shumë regjionin e Gjilanit.

Sokol Haziri- pasi që jemi Komunë fqinje me Ferizajn, iu uroj përgëzime për zgjedhje korrekte dhe urime për fituesin e zgjedhjeve, duke iu uruar sukses dhe punë të mbarë.

Unë nën të ndryshme kam një propozim lidhur me Komisionin për PPP dhe lidhur me rregulloren e tillë dhe një kërkesë përkitazi me këtë formacion.

Mirëpo këto gjëra do t' i specifikoj më mirë në nën të ndryshme.

Sami Hoxha- unë e kam një informatë të shkurtër e cila është për disponim të të gjithëve. Unë iu njoftoj se nxënësit e Komunës së Gjilanit të cilët kanë marrë pjesë në garat në Olimpiadën e Matematikës në Vlorë e cila është mbajtur më 27 maj, Komuna e Gjilanit ka artit rezultate jashtëzakonisht të kënaqshme. Nxënësjë e klasës së tetë Doruntinë Sylejmani ka zënë vendin e dytë në nivelin kombëtar, kurse në nivel të Kosovës është e para. Në këto gara kanë garuar nxënësit nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës, në të cilat gara kjo nxënëse është e dyta.

Gjithashtu edhe një nxënës i Shkollës “Selami Hallaçi” ka zënë vendin e tretë për klasat e nënta, kurse dy të tjerë kanë zënë pozita të Lavdërimit. Nga 10 nxënës që i kemi pasur në ato gara, 4 prej tyre kanë arrit rezultate të lakmueshme, mirëpo Doruntina ka marrë edhe medalje që është në nivelin kombëtar.

Unë desha ta jap këtë informatë në Kuvend, sepse është një informatë e cila i gëzon të gjithë.

Elisah Ymeri- edhe mua realisht më gëzoi kjo informatë, sepse tani e tutje edhe Gjilani mund të krenohet me diçka në sajë të angazhimit edhe të partisë në pushtet, sepse normat që ne i kemi bërë nëpër shkolla flasin me rezultate.

Gjithashtu nën të ndryshme e kam një kërkesë ose ankesë në rrugën “Ibrahim Pacolli” afër Lumit Banja, sepse qytetarët e kësaj lagjeje janë në rrezik të përhershëm. Unë kërkoj që një ekip nga drejtoritë përgjegjëse ta vizitojnë këtë lagje, sepse aty ka vërshuar uji nëpër shtëpi dhe brenda, podrumet e shtëpive janë të mbushura me ujë.

Sami Azemi- edhe unë e kam një kërkesë nga banorët e fshatit Pogragjë e cila kërkesë ka të bëjë për pengesat të cilat janë vendosur në rrugën Gjilan – Pogragjë, por sidomos në mes fshatit Malishevë dhe Uglar. Mirëpo këtë kërkesë do ta elaboroj më gjatë nën të ndryshme.

Qemajl Mustafa- e kam një propozim – vendim të cilin unë në cilësinë e kryetarit të Komunës të cilin po insistoj për të hyrë si pikë e rendit të punës për t’u bërë vendim. Ky propozim është për kundërshtim për shitjes së ish objektit “Pireva” nga AKP. Qysh moti toka iu është dhënë në shfrytëzim Kombinatit Bujqësor “Mlladost” në vitin 1983, të cilën kontratë e kemi gjet me të cilën iu është dhënë në shfrytëzim.

Toka është e Komunës dhe nuk është bërë ndonjë ndërrim i titullarit. Objekti ka qenë montues dhe mjaft qartët thuhet, sepse ka qenë për nevoja të përkohshme të “Mlladostit” ose më saktë të njësisë “Promet” të kësaj ndërmarrje. Ne e kemi ditë që vlera e atij objekti tash është zero, sepse prej vitit 1983 kanë kaluar 30 vjet.

Në anën tjetër objekti nuk ka qenë fare i regjistruar në Kadastër si objekt, ndërkaq me normën në fuqi të Urbanizmit dhe Planit detal urbanistik të asaj zone, ajo zonë është e gjelbër. AKP e ka regjistruar në listën e pasurive të “Prometit” edhe përkundër insistimit tonë në kohën e duhur që të hiqet nga shitja, ata e kanë refuzuar një gjë të tillë dhe ne jemi ardh para aktit të kryer, sepse iu është shit dikujt. Ai person i cili e ka blerë atë objekt e ka bërë një renovim, mirëpo ne e kemi kundërshtuar këtë në gjykatë përmes Gjykatës Komunale. Lënda shpejt arrin në dhomën e veçantë të Gjykatës Supreme dhe është obligim i këtij Kuvendi që zëshëm ta kundërshtojë një shitje të tillë dhe të mos e pranojë si shitje!

Nuk do të duhej të pranojmë shitje pa negociim me Komunën dhe të shiten objekte në pronë të Komunës. Kjo i bie që të shitet aseti inekzistent, sepse vlera e tij është zero në tokën e Komunës.

Për këtë arsyeje unë e kam bërë një propozim, të cilit ia kam shtuar edhe një pikë(pikë 4) se nuk ka qenë i regjistruar në Kadastër si aset. Unë e thash se lënda është në gjykatë dhe jam i bindur se gjykata do ta merr një vendim meritore në favor të Komunës.

Izmi Zeka- kush është për këtë rend të punës me vërejtjet që u bën, duke e plotësuar me këto nën të ndryshme, prandaj kërkoj që të deklaroheni se kush është për këtë rend të punës me këto plotësime?

Aprovohet rendi i punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

Procesverbali

Nuk pati vërejtje në procesverbal dhe u aprovua pa vërejtje

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2.1 Raporti financiar tre mujor janar-mars 2012,

Izmi Zeka – lidhur me këtë pikë fjalën do ta ketë drejtori i cili do ta elaboroj këtë raport në vija të trasha mandej e hapim debatin.

Nuhi Nuhiu- ju e dini se ne jemi të obliguar që në çdo tre muaj ta paraqesim raportin financiar, prandaj ky raport ka të bëjë me periudhën janar- mars 2012. Të gjitha shpenzimet që janë bërë ato janë bërë në bazë të planifikimit për vitin 2012. Nga kjo shihet se rrjedhja e parasë dhe kesh plani ka qenë i tillë të që t’i përmbahemi planit të cilit ka qenë desh t’i përmbahemi në formë

strikte. Ju e keni pasur materialin dhe e keni vërejt se gjatë kësaj periudhe e keni pasur një buxhet të shpenzuar prej 5 milion e 302 e 624 euro. Nga granditë Qeveritar mbi 2 milionin e 850 mijë janë paga dhe mëditje, kurse mallra dhe shërbime 608.211 euro, shpenzimet komunale 108.999.00 dhe shpenzimet kapitale 1 milion e 95 mijë euro. Nga të hyrat vetanake kemi një shpenzim prej 300 e 58 mijë e 869 euro.

Do të thotë pjesa dërmuese ka shkuar në investime kapitale prej 171 mijë e 277 euro.

Prej të hyrave vetanake nga viti 2011 kemi pasur shpenzime në mallra dhe shërbime prej 248 mijë e 540 euro, shpenzim kapital prej 82 mijë dhe gjithsej 331 mijë 172 të bartura nga viti 2011. Sa i përket të hyrave vetanake nuk është realizuar në tërësi plani dhe është arrit shuma prej 575 mijë e 806 euro, kurse në përqindje kjo i bie 77% të të hyrave vetanake. Lidhur me të hyrat vetanake është gjithmonë një periudhë me e rëndë, sepse për qytetarët këta muaj janë të ngarkuar me probleme ekonomike dhe familjare.

Në vijim të fjalës së tij drejtori dha edhe sqarime më detale të cilat të dhëna, anëtarët e Kuvendit i posedojnë në raport me shkrim.

Zijadin Maliqi-unë kryesisht rreth këtij raporti financiar do të flas në vija të trasha dhe së pari po e them se të hyrat nuk e kanë një realizmi prej 77%, por për mua nuk është ky realizim, por për mua është një realizim prej 17.50%. Këtë vërejtje më duket se e kam dhënë edhe vitin e kaluar, sepse përqindja e realizmit të të hyrave nuk nxirret në këtë formë, sepse nxirret në raport me të hyrat e planifikuara.

Të hyrat e planifikuara janë 3 milionë 290 mijë euro. Ne nuk kemi bërë planifikim të të hyrave për muaj dhe periudha tremujore, por kemi bërë planifikim për tërë vitin, sepse kështu nxirret realizmi i të hyrave, do të thotë raporti në mes të hyrave të planifikuara dhe të realizuara për këtë vit është 17.50%.

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, m' u duke se drejtori e dha 93%, por ajo është 82.89%.

Është një shqetësim, për atë se pse është një ngecje në të hyra? Unë kam vërejt se në disa kategori të caktuara ka të hyra më tepër të realizuara, por kam vërejt një ngecje krahasuar me vitin e kaluar të tatimit në pronë, sepse këtë vit i kemi të inkasuara rreth 100 mijë euro më pak ose 37% më pak se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Këtu është mirë Drejtoria e Financave të na japin një sqarim se çka ka ndikuar në këtë ngecje. Kushtëzimet ekzistojnë edhe këtë vit, kurse objektet nuk janë duke u zvogëluar, por janë duke u rritur, sepse tash e dimë se posa të mbulohen ato tatimohen, por me një shkallë më të ulët. Lidhur me këtë a është bërë ndonjë analizë pse ka ardhur deri te kjo?

Sa i përket shpenzimeve i kam analizuar detalisht dhe kamë vërejt se po vazhdon ai trendi i rritjes së shpenzimeve nëpër kode të caktuara të cilat i kemi thënë edhe në raportin përfundimtar financiar për vitin 2011. Unë nuk do të lëshohem në këto gjëra, por kisha kërkuar që në disa kode buxhetore të zvogëlohen shpenzimet, sepse këtë nuk na e falin as qytetarët.

Te investimet kapitale e pash që është një vlerë prej 1 milion e 349 mijë euro e cila është vlerë bukur e madhe, por tash kur e shikojmë listën e prokurimeve e vërejmë se ka shumë pak tenderë të shpallur në infrastrukturë rrugore. Është mirë që të marrim sqarime nga drejtoria se si janë krijuar këto shpenzime?

Këto ishin vërejtjet e mia në pika të shkurtra.

Ramiz Ramadani-së pari i përgëzoj nxënësit e Gjilanit për suksesin e arritur. Sa i përket raportit të drejtorit, unë i kam disa interesime për të cilat me siguri do të marrë përgjigje.

Te shpenzimet e udhëtimit brenda vendit është një shumë për tre muaj 64.349.89 i cili shpenzim m' u ka dukë enormë për të cilat kisha kërkuar sqarime?

Te shpenzimet telefonike “Vala 900”, por edhe PTK së bashku janë shpenzuar 15 mijë e 960 euro e që për ditë pune i bie 245 euro e cila shumë për mua është shumë e pa qartë?

Për karburantet për vetura kemi një shpenzim prej 42.864.14 i cili shpenzim konsideroj se është tepër i madh.

Drekat zyrtare i kemi 48.656.68 e që për ditë pune del 740 euro.

Mendoj se është një tre mujor i parë ka mundësi për korrigjime dhe besoj se do të ndodh kjo!

Nuhi Nuhiu-sa i përket asaj që e tha Zijadini, sepse po i paraqesim në atë formën vetanke 83%, kurse 77% ishte si normë fillestare, atëherë duhet shpenzimet mos të shkojnë 98, ta marrim vitin buxhetor dhe ta zbresim diku në 20%. Mirëpo kjo nuk do ta ndryshojë gjendjen pa marrë parasysh a do të shkojmë 17% apo 77% gjendja do të jetë e tillë. Ne gjithmonë raportin e kemi bërë duke marrë parasysh planifikimin vjetor dhe në bazë të këtij planifikimi vjetor do t’i paraqesim edhe të hyrat vetanake dhe shpenzimet.

U bë pyetje për ngecjen e tatimit në pronë e cila është e vërtetë se kemi ngecje, por nuk qëndron ajo që thuhet se në vitin e kaluar kemi pasur kushtëzim. Nuk kemi pasur vitin e kaluar kushtëzim për Hidromoravë dhe Higjienë për tremujorin e parë, por kushtëzimin e kemi filluar diku në muajin korrik.

Një arsyeje tjetër e ngecjes është edhe ajo se disa automjete regjistrohen edhe në komuna të tjera, kurse ne nuk kemi fuqi ligjore për t’i ndalur dhe mos t’i lejojmë që të shkojnë në komuna të tjera.

Një faktor tjetër është se këtë vit ka qenë një dimër tejet i ashpër dhe shumë pak njerëzit kanë regjistruar automjete.

Mandej thuhet se në disa kode ka shpenzime të mëdha dhe te investimet kapitale. Ju raportin financiar të vitit 2011 e keni marrë dhe në atë raport te pasqyrat financiare të cilat i kemi prezantuar ne kemi pasur obligime. Këtë vit qysh në start kemi filluar për t’i shlyer obligimet e vitit 2011.

Të gjitha ato që i tha Ramizi janë obligime të bartura dhe nuk janë obligime të cilat janë krijuar gjatë vitit 2012, por në çdo mënyrë këto obligime duhet të shlyhen. Këtë vit në raportin gjashtë mujor do ta shihni se këtë vit do të kemi shpenzime shumë më të vogla në krahasim me faturat e vitit të kaluar.

Mandej, Zijadini e thotë se nuk kemi pasur investime kapitale dhe tenderë, mirëpo duhet të dihet se kemi pasur obligime të cilat nuk mund t’i fshehim, sepse janë të paraqitura.

Këto ishin përgjigjet e mia dhe besoj duhet të jeni të kënaqur me këto përgjigje.

Nevzad Rushiti- edhe unë do ta kërkoj një sqarim nga drejtori edhe pse parafolësit e mi i thanë shumë gjëra? Së pari është një kod “furnizim me ushqim dhe pije”, 17 mijë e 70 euro. Unë po kërkoj saktësisht se ku janë bërë këto shpenzime për pije dhe ushqim?

Tjetra është vaj për të cilin kemi biseduar edhe vitin e kaluar dhe është sqaruar se është vaj i makinave dhe në këtë kod janë 2600.00 euro për tre muaj. Për mua kjo është shumë e madhe, sepse për 20-30 automjete sa i posedon Komuna, paska qenë e nevojshme të gjitha makinave t’i ndërrohet vaji?

Tjetra është mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve i kemi harxhime 40. 538.00 për tre muaj edhe pse shumica e automjeteve janë të reja, kurse në anën tjetër ka shpenzime të mëdha për riparim.

Ka edhe disa kode të tjera, por unë i thash disa më me rëndësi.

Zijadin Maliqi- unë i thash disa gjëra në vija të trasha, por pas fjalës së drejtorit po e them se është mirë që realizmi kur të bëhet si i të hyrave si i shpenzimeve, kuptohet keq në qoftë se merret për

tre muaj jo, sepse për tre muaj nuk kemi bërë planifikim. Në këtë mënyrë bëhet në çdo vend dhe nuk qëndron ajo që rritet ose zvogëlohet përqindja.

Te tatimi në pronë unë nuk e thash që kanë qenë kushtëzimet për Higjienë dhe Hidromoravë, por e thash kushtëzimi ka qenë për tatimin në pronë edhe vitin e kaluar, por të hyrat këtë vit nuk janë realizuar. Gjithashtu edhe unë po dëgjoj se shumë njerëz automjetet e tyre po i dërgojnë në komuna të tjera për t' i ikur procedurave të gjata, kurse ne si Komunë dëmtohem për ato kushtëzime që i kemi bërë. Drejtori e tha se ka borxhe, por edhe unë e kam ditur që janë borxhe, por duhet të thuhet me një fjali dhe kjo ishte mbyll paraprakisht. Duhet ta dijë Kuvendi se kur janë krijuar këto obligime, sepse në këtë formë Kuvendi është më i qartë.

Qemajl Mustafa- ne në fakt u sqaruam, por mos të krijojmë huti para publikut, gjegjësisht para medieve të cilat nesër e pasqyrojnë këtë diskutim. Pasi ky është raport tre mujor duhet të jemi shumë konciz dhe duhet të jemi kritik ndaj drejtorit. Drejtori duhet të jetë shumë më energjik në mbrojtjen e asaj që e thotë. Raporti është tre mujor, nuk është vjetor, kjo shumë mirë thuhet. Pasi që është tre mujor ne flasim për 100% të atij tre mujori. Nuk të kupton publiku nëse i thua 17% të planifikimit vjetor është realizuar. Mund të thuhet edhe kjo si shpjegim, por atëherë duhet të dihet dhe thuhet se realizmi për këtë tre mujor do të duhej të jetë 25%. Publikun shumë saktë do të duhej për ta informuar dhe 25% është norma 100% për tre muaj. Kështu është planifikimi dhe atëherë mund të themi 17%, por nuk duhet se shkaktohet huti.

Për mua duhet të operojmë ashtu si ka operuar Drejtoria me 77% në këtë rast, prej 100%.

Raporti financiar paraqitet në momentin e kryerjes së transaksioneve dhe këto transaksione kanë ndodhur në këtë periudhë dhe do të thotë shlyerja e obligimeve.

Arben Mehmeti- më duket pak si tepër, sepse çdo gjë që po diskutojmë po na merret si diçka jo meritore, kurse ne jemi duke dashur që ta japim një kontribut pozitiv në këtë çështje. Ju po i merrni të gjitha sukseset si meritat të juaj, të pushtetit të PDK-së. Në këtë rast u mor një nxënëse si meritë e PDK-së dhe ka mbet jashtë kësaj merite të PDK-së vetëm Rona Nishliu dhe ai Arbëri në Big Broder!

Ne duam thjeshtë një pyetje për kryetarin në këtë rast se, drejtori dhe drejtoria duhet t' i specifikojë saktësisht me një vërejtje në këtë raport dhe të thuhet se këto shpenzime janë obligime të vitit 2011 dhe janë obligime ndaj punëve që janë kryer. Jo në këtë formë, sepse kjo kuptohet se këto shpenzime janë kryer në këtë periudhë. Fjala publike është me rëndësi, sepse thuhet se janë kryer obligimet tërësisht ndaj obliguesve dhe kjo është fjalë publike e menaxheres së Zyrës së Prokurimit dhe disa zyrtarëve të tjerë. Në kërkesën që ne ia kemi dorëzuar Zyrës së Prokurimit, del se janë edhe 100 e 1 mijë euro borxh, kurse në anën tjetër është deklarim publik se nuk e kemi asnjë centi borxh.

Në një raport të cilin e posedojmë del se Komuna i ka 100 e 10 mijë euro borxh. Është mirë që deklarimet publike mos të jenë të pavërteta dhe të pasakta e cila është bërë praktikë në Komunë. Unë do të jem konkret dhe po theksoj se e kemi pasur projektin e mirëmbajtjes verore të rrugëve për të cilin rast e kemi pasur një deklarim publik të drejtorit të Shërbimeve Publike se kjo fillon në muajin maj, i cili muaj kaloi dhe unë nuk kam parë asnjë aktivitet në këtë drejtim, kurse gjendja e rrugëve të Gjilanit është jashtëzakonisht e keqe. Mirëpo tash në raportin financiar na dalin 65 mijë euro që janë harxhuar për mirëmbajtje verore të rrugëve dhe këto shifra dhe këto shpenzime a ka rrezik që këto tenderë që janë shpallur nga Zyra e Prokurimit që të mos realizohen? Nëse janë shpenzuar këto mjete tash a ka rrezik që mos të realizohen projektet e parapara për këtë vit?

Kjo është pyetje për kryetarin e Komunës, saktë a ka mundësi për t' u rrezikuar procesi i dhënies së tenderëve për të cilët është nënshkruar kontratë për shkak të obligimeve që janë nga viti i kaluar?

Kërkojmë nga kryetari i Komunës që ta na japin një sqarim adekuat?

Arben Maliqi- unë fillimisht po e theksoj se në emër të grupit tim, pas analizave që i kemi bërë e përsëritës raportin tere mujor të viti 2012, në të cilin raport drejtori në vija të trasha i paraqiti të gjitha ato shpenzime që kanë ndodhur. Mirëpo drejtori edhe vërejtjet që pati opozita, ai në mënyrë profesionale i sqaroi mjaft mirë. Ne të vetmin shqetësim që e kemi pasur është te shpenzimet të cilat rriten nëpër kode të caktuara, por ato i sqaroi drejtori se ato janë shpenzime të bartura kështu që për neve çdo gjë është në rregull.

Sami Hoxha- unë e dhashë një informatë për disponimin e të gjithëve dhe nuk e thash që është meritë e PDK-së ose LDK-së. Suksesi i fëmijëve tanë është suksesi i të gjithëve, sepse janë fëmijë të të gjithëve dhe me ata ka punuar stafi arsimor. Nuk e tha as kryetari as kryesuesi që është meritë e PDK-së.

Nëse ka disponime personale ato janë të çastit, por edhe është shumë reale që ne kemi krijuar hapësirë dhe institucionet komunale kanë krijuar mundësinë që fëmijët tanë të shkojnë në ato gara për ta dhënë kontributin e tyre dhe për ta treguar talentin e tyre. Mirëpo unë po e them se talenti i tyre është orientuar mirë nga mësimdhënësit e tyre. Po mos t' i kishim mësimdhënësit të cilët kanë punuar mirë me siguri nuk do të ishte ai sukses. Ky rezultat është meritë e të gjithëve, është meritë e stafit që kanë punuar dhe është për t' i përgëzuar për punën e mirë që e kanë bërë dhe ne të gjithë duhet të jemi të lumtur për atë sukses dhe jo vetëm PDK ose LDK, sepse kjo vlen për të gjithë.

Kjo është meritë shumë palëshe.

Elisah Ymeri- unë e përkrahi Samiun dhe ajo qëndron, sepse nuk duhet të politizohet, por ky sukses është edhe në sajë të angazhimit të mirë të këtij pushteti. Unë krenohem në qoftë se edhe opozita në të ardhmen nëse vijnë në pushtet, kur të kenë suksese, personalisht do t' i përgëzoj.

Arben Mehmeti- unë nuk e kam të qartë, pse Sami Hoxha po merret tepër me çështje të arsimit, sepse tash nuk punon në DA, prandaj si anëtar i Kuvendit pse kaq shumë po merret me çështjen e kësaj drejtorie? A ka qenë organizator i këtij manifestim apo çka është në pyetje?

Nuhi Nuhiu- më duken interesante disa pyetje sikur është ajo pse keni filluar t' i shlyeni obligimet? Mirëpo ato duhet të shlyhen, pastaj të hyjmë në obligime. Raporti financiar i 2011 decidivisht iu a ka treguar të gjitha obligimet që i kemi si Komunë dhe nuk kemi se çka të bisedojmë më tutje. Ai raport është debatuar në këtë Kuvend, është aprovuar dhe patjetër ato obligime duhet t' i shlyejmë.

Qemajl Mustafa- nga ana ime ishte i orientuar Arbeni. Për obligimet kemi thënë kështu: nuk keni për ta gjet në atë Departamentin e Prokurimit se figuron që Komuna nuk ka asnjë cent borxh. Obligimet secilën ditë të punës rriten, por edhe jo vetëm të punë por edhe gjatë vikendeve rriten dhe kurrë nuk do të jenë zero.

Mirëpo e kemi thënë krahasuar me 2 milion e 100 mijë sa kanë qenë obligimet tek investimet kapitale kemi ardh pranë zeros, sepse Zyra e Prokurimit merret vetëm me këtë pjesë të investimeve kapitale.

Kemi ardh te shlyerja e obligimeve për punët e kryera të kuptohemi dhe jo për të gjitha projektet, sepse projektet vazhdojnë, por për punët që i kemi përfunduar, obligimet i kemi pranë zeros.

Këto 100 mijë euro, nuk janë obligime të mëdha për një Komunë.

Sa i përket mirëmbajtjes verore iu siguroj se nuk do të ketë asnjë çalim në asnjë aspekt.

Izmi Zeka- ju lutem të deklaroheni se kush është për aprovim të këtij raporti?

Miratohet pika 2.1 e rendit të punës: Raporti financiar tre mujor janar-mars 2012, me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, 14 ishin kundër, kurse 5 abstenime

2.2 Propozim Rregullorja për Shërbimet Publike Komunale,

Azem Mujku- rregullorja për Shërbime Publike është një rregullore e cila i përfshin kushtet e pastërtisë dhe Higjienës në territorin e Komunës së Gjilanit. Kjo rregullore i përfshin vendbanimet ndërmarrjet institucionet, organet e administratës dhe të tjerat që bëjnë jetë të organizuar apo individuale.

Në këtë rregullore përcaktohen normat dhe aspektet e shërbimeve publike si; furnizimi me ujë, pastrimi i ujëra të zeza dhe atmosferike, sipërfaqet e gjelbra, sipërfaqet publike në vendbanime, bartja dhe deponimi i mbeturinave, rregullimi i sipërfaqeve publike, ndriçimi publik, terrenet sportive, rregullimi dhe mirëmbajtja, sinjalizimi dhe numerizimi i rrugëve dhe shesheve dhe objekteve tjera.

Për zbatim të kësaj rregulloreje janë të obliguara Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspeksionit, ajo Urbanizmit.

Nga neni 33 deri në fund janë të parapara masat ndëshkuese për zbatimin apo mos zbatimin e tyre. Miratimi kësaj rregulloreje sot është shumë i domosdoshëm, sepse ndihmon inspeksionin në radhë të parë dhe shërbimet e tjera të Kuvendit dhe drejtoritë përkatëse në ofrimin e shërbimeve publike komunale për qytetarët e Komunës së Gjilanit.

Elisah Ymeri- unë nuk kam diçka të veçantë për të shtuar, por e mora fjalën që ta përgëzoj Azem Mujkun për këtë punë aq të madhe të cilën e ka bërë, kontributi i të cilit ka qenë në vazhdimësi për shërbimet publike dhe është puna më e mirë që është bërë në këtë drejtori.

Sadudin Berisha- grupi parlamentar i LDK-së me shumë kujdes dhe përgjegjësi e ka analizuar rregulloren për shërbime publiko-komunale dhe ka konstatuar që është në interesin e Komunës që të kemi një akt të tillë nënligjor për rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme publike.

Kjo çështje ka një formë të rregulluar, por kjo në një mënyrë e bën një përmbledhje të qartë të normatizimit të së drejtave dhe përgjegjësi të cilat i kanë institucionet dhe qytetarët për shërbim të mirave publike për të gjithë qytetarët e Komunës.

Ne kemi vlerësuar me të drejtë se në këtë rregullore kemi edhe gabime të shumta materiale e të cilat janë ndikuese në implementimin e saj, por ne nuk jemi pengesë e procesit të mëtejshëm dhe është detyrë dhe obligim i përhershëm i këtij KK, që e njëjta të rishikohet së paku në çdo gjashtë muaj me qëllimin më të mirë që të mos mbetet një akt formalisht në fuqi, mandej i pazbatueshëm ose vështirë i zbatueshëm për shkak të rrethanave që sot i kemi në infrastrukturën komunale.

Ne detyrimisht deri në fund të këtij viti duhet të bëhet një rishikim nga drejtoria përkatëse dhe komisionet tjera me vlerësimin e nivelit të zbatimit të kësaj rregulloreje.

Vështirësitë të cilat do të jenë në zbatim, vërtetë do të jenë të mëdha, kurse gabimet materiale kemi kërkuar edhe në Komisionin për akte nënligjore të eliminohen dhe tekstualisht të shikohen, por edhe gjuhësisht të përmirësohen.

Grupi i LDK-së e mbështet këtë rregullore me obligimin që në afatin kohor deri në fund të këtij viti të rishikohet edhe njëherë.

Izmi Zeka- ne së pari e falënderojmë Drejtorinë për Shërbime Publike dhe komisionin që ka punuar në këtë rregullore, prandaj kërkoj që të deklaroheni se kush është për miratim?

Miratohet pika 2.2 e rendit të punës: Propozim Rregullorja për Shërbimet Publike Komunale, me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

2.3 Shqyrtimi i kërkesës për shfuqizimin e vendimit të miratuar nga KK-Gjilan, Nr.01.8367 të datës 09.07.2010 për ndalimin e shitjes të pronave publike nga AKP-ja,

Izmi Zeka- ne më parë kemi marrë një vendim, por është një kërkesë për shfuqizim të atij vendimi, mirëpo për këtë sqarimet më detale do t' i n ai jep kryetari.

Qemajl Mustafa- unë mendoj se kjo pikë është në kundërshtim të plotë me atë pikën që e propozova unë! Unë e kam bërë një vendim dhe ju duhet ta lexoni dhe ky vendim nuk bie ndesh me asgjë nga ajo që është e drejtë e një komune ose e drejtë e një pushteti lokal për pronë. Ne kemi marrë vendim që të mos shiten pa konsultim paraprak përmbajtjesor me Komunën asnjë pronë në hapësirën e Komunës, brenda zonës urbane dhe jashtë saj, sepse po biem në situata në të cilat kemi ardhur. Unë po e përsëris se AKM-ja e atëhershme ka qenë Qeveria mbi dy qeveritë në Kosovë. AKM ka qenë Qeveria më e fuqishme, sepse absolutisht nuk është marrë as me atë pjesën e UNMIK-ut, as pjesën e institucioneve të përkohshme të Kosovës. Kjo mënyrë e sjelljes së AKM-së i ka shkaktuar shumë dëm ekonomisë së Kosovës. Degradimi i komunave ka ngel sa i përket tokës dhe pronës për shkak të kësaj paqartësie për shkak të këtij autoriteti të madh që ligjet ia kanë dhënë AKM-së gjegjësisht tash AKP-së. Ne jemi padroni i hapësirës së Komunës i tokës dhe objekteve dhe i gjithë asaj që është aset komunal. Nëse dikush lejon që në oborrin tuaj të hyjë njëherë përkohësisht për ta zhvilluar në aktivitet dhe mandej të bëhet hisenik i përhershëm në oborrin tuaj, atëherë le të thuhet?

Një gjë e tillë nuk duhet të lejohet dhe unë jam i mendimit që të mos merremi me këtë shfuqizim, absolutisht, ne të ecim përpara, kurse ajo të mbesin në fuqi.

Ne obligimin tonë po e kryejmë si Kuvend i Komunës ndaj qytetarëve të kësaj Komune, ndaj pronës së tyre nëse sillemi dinjitetshëm Nëse e shfuqizojmë këtë unë e tërheq atë propozim-vendim për marketin “Pireva” .

Izmi zeka- së pari Drejtoria për Gjeodezi, nuk e kam të qartë se me çfarë arsye dhe procedure e ka sjell një propozim në komitete dhe procedura të tjera . Unë e lus drejtorin që herëve të tjera që të konsultohet me kryetarin, kurse pas këtij konsultimi i bie kërkesat për t' i diskutuar ne.

Gani Neziri- ky propozim-vendim nuk ka ardh me pëlqim timin, unë kam qenë kundër kësaj. Këtu është kërkesa e AKP-së ku thuhet; “kjo parcelë evidentohet si pasur shoqërore, pasuri e përgjithshme popullore” Kjo nuk është pasuri si ndërmarrjeve publike, por pasuri e përgjithshme popullore, nuk është si “ Çeliku” , Fabrika e Bativerive, “Integji. Pasuri e përgjithshme popullore është Ekonomia Pyjore dhe nuk ka qasje në Ekonominë Pyjore AKP-ja. Unë mendoj se është e drejtë e AKP-së të bëjë kërkesë për ndërmarrje të tjera, por jo edhe për Ekonomi Pyjore.

Sabedin Kadriu- çdo institucion në Republikën e Kosovës e ka një formë të komunikimit dhe dihet se kur dhe kujt i bëhet kërkesa? Së pari vërejtje për sekretarinë nga unë personalisht, sepse kërkesa nuk mund të sjellin shefat, sepse ne i kemi drejtoritë dhe ato i japin raport këtij Kuvendi. Për mua kjo kërkesë as që duhet të diskutohet sot. Edhe njëherë vërejtje se sekretari nuk mund të fus pika të rendit të punës për pa pasur nënshkrim të drejtorit.

Sadudin Berisha- pajtohem plotësisht me vlerësimin që e dha pak më parë kryetari i Komunës, por mendoj se atë vlerësim dhe gjykim ka qenë desh ta bëjë në adresën e caktuar në Qeverinë e

Kosovës dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës. Nuk them se ndoshta nuk e ka bërë, por adresa e kësaj çështje është atje. Edhe në komentimin e miratimit të vendimit për ndalimin shitjes së pronave komunale që ka të bëjë e që ka ndodhur me 9 korrik të vitit 2010, grupi i LDK-së e ka thënë qartë: nuk është kompetencë është tjetër se është interes i Komunës për ta pasur patundshmërinë në shërbim të vet, por nuk është kompetencë me ligjin në fuqi kjo çështje dhe nuk mund KK të ndikojë në vendimin e AKP-së apo më herët AKM-së. Ne e kemi thënë se ky vendim për ndalimin e shitjes së pronave është nul (i pazbatueshëm) dhe jo efektiv. Tani jemi në të njëjtën situatë, sepse asnjë veprim juridik nuk mund të ndikojnë. Gjithashtu edhe vendimi i kryetarit për ndalimin e shitjes së pronës së ish “Mlladostit” e ka veprimin nul. Kryetari i Komunës me kompetencat që i ka do të duhej të komunikojë me Qeverinë e Kosovës dhe përmes Asociacionit të Komunave të Kosovës. Ne e kemi thënë qartë se me këtë veprim është dëmtuar Komuna, por veprimi këtu është nul. Ne jemi për ta ruajtur pasurinë, por në këtë mënyrë jo, sepse ligjet e pamundësojnë, sepse këto ligje janë miratuar jo më herët se para 4 viteve pas Pavarësisë së Kosovës. Për këtë arsye neni i parë i dytë dhe veprimi i tretë për neve paraqesin një veprim nul dhe nuk paraqesin asnjë veprim ligjor.

Qemajl Mustafa- është e vërtetë ashtu në aspektin juridik, por Asociacioni i Komunave, kohë të gjatë ka debatuar për këtë çështje me AKP-në dhe Qeverinë dhe kemi arrit që ta dërgojmë në Kuvend ligjin për këmbim të tokave me AKP-në dhe dhënien e tokës komunale në shfrytëzim.

Izmi Zeka- të na jep sqarime z. Sali Fazliu si është propozuar ky vendim për Kuvend?

Qemajl Mustafa- nuk duhet lejuar talljen me KK-në. Ky propozim ka ardhur në Kuvend, sepse unë e kam thënë nëse dëshironi për të komunikuar në mënyrë të relaksuar dhe për të negociuar për secilin rast, kështu disi është thënë, atëherë duhet ta shfuqizoni këtë dhe kemi desh për ta bërë një gjë të tillë. Mirëpo po shihet se çka po ndodh, ata fare nuk dëshirojnë për të komunikuar me Komunën.

Unë disa herë kam desh për ta rrënuar marketin “Pireve”, sepse vlera e tij ka qenë zero, sepse kanë kaluar 30 vjet.

Sabedin Kadriu- ne po flasim kot, sepse këtu nuk ka asnjë nënshkrim të kryetarit, sepse kjo shkresë ka qenë desh ta ketë një nënshkrim të kryetarit dhe kështu do të ishte një formë e komunikimit institucional.

Izmi Zeka- unë po propozoj që ky vendim mos të shfuqizohet, por të mbetet në fuqi vendimi ekzistent?

Miratohet propozimi që ky vendim, mos të shfuqizohet, por të mbetet në fuqi vendimi ekzistent me 22 vota të anëtarëve të Kuvendi, kurse të tjerët abstenojnë.

2.4 Propozim vendimi për dhënien e pëlqimit për ndërrimin e një pjese të pronës komunale me një pjesë të pronës private te Lagja “Zabeli i Sahit Agës” ZK- Gjilan,

Izmi Zeka- lidhur me këtë pikë të rendit të punës, kryesuesi propozon që arsyetimin për këtë ta jep zyrtari për pronë në Drejtorinë e Kadstrit z. Sali Fazliu

Sali Fazliu- qytetari Qamil Selimi i cili jeton në “Zabelin e Sahit Agës” e posedon një parcelë afër Lumit Mirusha e cila kufizohet me rrugë publike, ku ka rrëshqitje të dheut në pronën e tij nga prona komunale. Për këtë arsye ky iu është drejtuar organeve komunale qysh në vitin 2008 në Drejtorinë për Emergjencë e cila drejtori ka konstatuar se me të vërtetë ka rrezik nga rrëshqitja e dheut. Mandej përsëri këtë kërkesë e ka bërë përsëri në Kadastër për të konstatuar këtë rast.

Ne kemi dalë në vend të ngjarjes dhe kemi konstatuar se rruga publike e cila shtrihet në pjesën veriore të parcelës të qytetarit për nevoja të rrugës iu janë marrë 127 m² për trasim të rrugës. Kërkesa e qytetarit është për ndërtimin e një muri në skaj të dheut ku rrëshqet në oborrin e tij. Ne kemi konstatuar se për kompensim të kësaj pjese e cila iu ka marrë për rrugë atij t’i epen afër 186 m me qëllim të ndërtimit të murit si mbrojtje nga rrëshqitja e dheut.

Abdyl Aliu- unë jam anëtar i Kuvendit i cili jam nga kjo pjesë e qytetit dhe për këtë propozim-vendim e kam pasur një interesim të veçantë dhe kam biseduar edhe me fqinjët e këtij zotërie i cili e ka bërë këtë kërkesë. Kam biseduar me fqinjët të cilët jetojnë me vite të tëra që jetojnë në atë lagje, por edhe e çmoj punën e të gjitha ekipeve të cilat kanë dalë në terren, mirëpo unë konsideroj se nuk është punuar deri në fund dhe rezultati i kësaj pune është për të dyshuar.

Ky pronar këtë pronë e ka blerë pas lufte dhe fqinjët e thonë se prona kur është blerë, rruga ka ekzistuar dhe ajo ndoshta ekziston në listë poseduese dhe në kopje të planit. Këso probleme ka shumë në Komunë të Gjilanit dhe ka shumë rrugë që shfrytëzohen, por nuk është bërë transferi. Nëse ky propozim miratohet kështu, atëherë paraqitet rreziku që të bëhen edhe shumë kërkesa të tjera, sepse ka shumë probleme të tilla, ku nuk janë bërë transferet. Të gjithë e dinë se kjo është rrugë, por nuk është bërë transeferi.

Për ta hequr këtë dilemë duhet të kërkohet prej këtij komisioni që të kërkojnë edhe kontratën e blerjes se kur e ka blerë dhe për ta vërtetuar se a e ka blerë me rrugë apo jo?

Këtu shihet se nuk është dokumentacioni i plotësuar, lista poseduese dhe kopja e planit.

I tërë problemi është se ka shumë këso raste dhe problemi tjetër është në anën e së cilës mendohet t’i epet prona edhe ajo është rrugë, mandej aty janë e dhe disa varreza për të cilat nuk kam njohuri se a i kanë pasur parasysh komisioni këto gjëra.

Unë kërkoj që të rishqyrtohet edhe njëherë ky rast?

Qemajl Mustafa- unë mendoj që Abdyl ka të drejtë, sepse dhe ushtruesi i detyrës së atij sektori Salihu e din se ka paqartësi sa i përket ndërrimit të tokave. Këtë ligj nuk e qartëson. Vlerësuesi në Prishtinë ka sqarim vetëm për aktet e shpronësimit, por jo edhe të kompensimit të pronave.

Mirëpo ne duhet ta marrim një vendim të veçantë dhe le të jetë kjo në seancën e ardhshme, ta sqarojmë bazën ligjore dhe nëse duhet ta marrim një vendim për themelimin e një komisioni për vlerësim. Komision në nivel lokal për vlerësim të raportit të pronave. Në ligj ju e dini që thuhet se kuvendet komunale nuk kanë të drejtë për të shit tokë. Në këtë rast i bie që ajo prona mbi 50 m, po tkurret ajo prona komunale për aq metra katror, në të njëjtën kualitet të tokës.

Unë jam për atë që ta shqyrtojmë bazën ligjore dhe e biem një vendim në seancën e ardhme.

Izmi Zeka – kush është për miratim të propozimit të kryetarit që lidhur me këtë pikët së pari të shqyrtohet baza ligjore, kurse në seancën e ardhshme të merret vendim meritore?

Miratohet propozim-vendimi 2.4: me propozimin që njëherë të shqyrtohet baza ligjore për këtë rast, kurse në seancën e ardhshme të merret një vendim në baza ligjore, me vota unanime të anëtarëve Kuvendit.

2.5 Rekomandim drejtuar MASHT-it për harmonizimin e Udhëzimit Administrativ Nr.10/2008 për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave, me LVL,

Izmi Zeka- këtë rast e kemi debatuar në komitet dhe forume të tjera dhe jam i bindur se jeni të gjithë në ngjarje.

Sadudin Berisha- ne e kemi thënë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa se është tjetër vullneti i ynë i brendshëm se si do të duhej të jetë kjo çështje! Mirëpo ai vullnet nuk mund të zbatohet derisa mënyra e rregullimit për një çështje të tillë është saktësisht e rregulluar me ligjet në fuqi.

Udhëzimi administrativ vetëm vlerëson interpretimin apo zbatimin e ligjit, procedurat. Kërkesat për ndryshimin e udhëzimit administrativ me LVL, që ka të bëjë me arsimin janë dy çështje krejtësisht të kundërta. Kjo çështje rregullohet me ligjin për arsimin fillor, parashkollor dhe të mesëm dhe saktësisht përcaktohen procedurat se si duhet të vihet deri te emërimi apo riemërimi apo ndryshimi i emrave të institucioneve shkollore. Për këtë arsyeje një kërkesë e tillë është fiktive sërish, sepse nuk është kompetencë e këtij Kuvendi, kurse në anë tjetër do të ishte mirë që ju si grup i PDK-së të kërkonin nga grupi i deputetëve të Kosovës, apo të ministrisë përkatëse që të fillojë procedura për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit parafillor, fillor dhe të mesëm dhe aty fillon burimi i kompetencave nga lartë në nivel të Komunës, në të kundërtën çdo lloj udhëzimi i administrativ që do të vijë nuk do të mund të ndryshojë interpretimin e ligjit nga ajo që është. Për këtë arsyeje unë mendoj se ky Kuvend po merret me disa gjëra të cilat nuk janë të saja dhe po humb kohë.

Izmi Zeka- ne po tentojmë për ta hapë debatin edhe për çështje të cilat i dimë se si rregullohen, por ne po duam për ta hapë debatin për një çështje e cila është e ndjeshme dhe kjo nuk e pengon nëse e bëjmë një rekomandim, një kërkesë e cila nuk e prish shkrimin e këtij Kuvendi i cili është shumë i mirë, por edhe nuk pengon edhe ata të Ministrisë së Arsimit.

Elisah Ymeri- ne duhet të kemi fuqi për ta shfuqizuar udhëzimin administrativ, por ne e kemi bërë një kërkesë që ata të merren me këtë çështje. Duhet të kuptohet se duhet bërë një kërkesë, sepse për pa pasur kërkesë të tillë askush nuk merret me këtë çështje. Na po duam për ta parandaluar që të lëmë edhe emra të çobanëve nëpër shkolla.

Izmi Zeka- kush është për t'ia bërë një rekomandim ministrisë?

Miratohet propozim vendimi 2.5.: Rekomandim drejtuar MASHT-it për harmonizimin e Udhëzimit Administrativ Nr.10/2008 për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave, me LVL, me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

2.6. Ndarjen e bursave për master, për studentët që studiojnë në Itali (rasti i Alketa Spahiut),

Qemajl Mustafa- ju e dini që i kemi 8 studentë në Itali, e të cilët janë të suksesshëm, por gjashtë prej tyre janë gati para përfundimit të bachelorit (tri vjet), por Alketa Spahiu e ka përfunduar dhe tash është në master në Itali, kurse pesë të tjerë janë në përfundim të tre vjeçarit.

Ne duhet ta marrim një vendim, a do t'ia financojmë edhe për dy vitet e ardhshme në master, apo jo? Kjo është një barrë për Komunën, ka qenë një financim diku afër 24 mijë euro në vit, do të thotë nga 3 mijë euro në vit për secilin. Ne duhet të marrim një qëndrim se do t'ia vazhdojmë financimin apo jo? Dihet se ata nuk ia dalin me forcat e veta, prandaj është mirë që t'ia ndihmojmë për të vazhduar me studime në Itali, për t'u kthyer të kualifikuar si duhet.

Arben Mehmeti- në bazë të pikës së rendit të punës këtu po shihet se është fjala për një rast, kurse këtu po flitet për të gjitha rastet. Mirëpo nga ajo që e sqaroi kryetari dhe pasi që kjo është edhe interes i Komunës së Gjilanit, sepse këta studentë do të na kthehen si kuadro ne si LDK e përkrahim këtë propozim.

Rashit Sahiti- unë po e shoh një kërkesë e cila nuk i ka kaluar të gjitha procedurat dhe ka ardh drejt në Kuvend. Ka qenë desh të jetë procedura e kundërt të shkojë në komitete, pastaj të vijë këtu! Mirëpo konsideroj se për këto kërkesa që i përmendi kryetari është mirë të bëhet një konkurse, sepse nuk janë vetëm këto 5-6 raste dhe mos të shkelen të drejtat e të tjerëve, sepse ka edhe shumë studentë të tjerë të cilët janë të suksesshëm. Nuk është vetëm Italia ajo që përgatiti kuadro, prandaj kujtoj se duhet të respektohen procedurat e konkursit.

Abdyl Aliu- unë e kam një pyetje për kryesuesin: kush prej juve i kupton këto dokumente të shkruara në gjuhën italiane? Këto dokumente ka qenë desh të përkthehen, mandej të sillen këtu.

Izmi Zeka- edhe unë nuk e kuptoj italishten, por e di tërë procesin kur kemi marrë vendim për këta nxënës për t' i dërguar në Itali. Jam në njohuri si ka shkuar procesi, por jam edhe në rrjedha se a kanë sukses apo jo? Këta nxënës janë të dalluar dhe për këtë i ka stimuluar Komuna, me qëllim që pas studimeve të kthehen si kuadër në Komunë.

Pasi që janë kuadër i ardhshëm unë jam që edhe më tutje t' i ndihmojë Komuna!

Elisah Ymeri- unë kam qenë i painformuar që Kuvendi ia ka dhënë vizën këtyre studentëve për të studiuar jashtë vendit, ne iu urojmë suksese dhe e përshëndesim këtë iniciativë e cila është shumë e mirë. Mirëpo kemi edhe një vërejtje të vogël në emër të grupit, sepse ne kemi edhe studentë të tjerë jashtë vendit e të cilët kanë rezultate solide, prandaj do të ishte mirë që t' i favorizojmë edhe ata. Është mirë që Komuna të formojë një komision për t' i ofruar ndihmë edhe disa studentëve të tjerë që të mos ngelin keq edhe të tjerët.

Shkëlqim Latifi- edhe unë pajtohem me këto diskutime, por është e nevojshme që ne t' i përkrahim sidomos nxënësit dhe studentët e dalluar të cilët i kemi stimuluar në Itali. Mirëpo edhe unë kam qenë i mendimit se ka qenë desh të respektohen disa procedura, të respektohet edhe Komiteti i Arsimit, por edhe t' i japim prioritet edhe nxënësve të tjerë të cilët kanë nevojë.

Mirëpo me sa jam i informuar edhe unë Ambasada e Turqisë ka ofruar një bashkëpunim për studentët kosovarë, do të thotë studime falas në të gjitha universitetet e Turqisë. Këtë po e them se pse ne t' i financojmë këta në Itali, kur nuk dallon Italia shumë prej Turqisë. Mendoj se pse ne t' i financojmë këta në Itali dhe këta për derisa mbarojnë bachelorin kanë mundësi studimet master t' i vazhdojnë në Turqi dhe pa pagesë, kurse me këto mjete ne do t' i ndihmojmë nxënësit e tjerë.

Sokol Haziri- edhe grupi ynë parimisht e mbështet këtë ide që të kreditohen apo të epen bursa nxënësve të dalluar. E dyta pajtohem me parafolësit e mi se duhet të jenë disa kriteret dhe të formohet një komision i veçantë i cili do të merrej me këtë çështje dhe të gjitha kërkesat të kalojnë nga komiteti përkatës deri në Kuvend.

Si propozim specifik për fund e kam që këto kuadro të cilat i financon Komuna, do të duhej që të kushtëzohen me një punë, një, dy ose tri vjeçare në Komunë. Kjo ka qenë praktikë e Qeverisë për kuadrot që i ka dërguar në shkollim jashtë vendit, por i ka obliguar që të punojnë në institucione të Republikës së Kosovës në një fazë të caktuar. Ashtu duhet të veprojmë edhe ne që t' i obligojmë këta studentë që për një kohë të caktuar të punojnë për Komunën e Gjilanit.

Bahrie Veseli-është fat i mirë që kemi studentë të mirë, sepse është një kënaqësi për të gjithë, por posaçërisht për prindërit. Unë nuk kam asgjë kundër këtyre studentëve, por ka edhe drejtime përkatëse dhe ka OJQ të ndryshme që japin bursa për master. Nga kjo rrjedh se pasi që janë studentë të mirë, i kanë rrugët e hapura dhe mund të orientohen në drejtime të tjera për përfitime të bursave. Unë nuk jam kundër këtyre, por shtrohet pyetja se a vetëm këta studentë i kemi që duhet t' i përkrahim dhe nuk kemi studentë të tjerë në Komunën tonë?

Për këtë arsyeje unë jam që të respektohet ligjshmëria dhe të përcaktohen kriteret, sepse ka shumë studentë të tjerë të cilët nuk janë përkrah asnjëherë nga kjo Komunë, kurse dikush përfiton me vite të tëra! Kjo për mua është e pa drejtë dhe shkelje e të drejtës njerëzore. Për këtë arsye unë jam që të respektohet ligji dhe të drejtat e njeriut.

Arben Maliqi- ne edhe në takimin e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi debatuar, por unë kam qenë i vetmi që kam abstenuar dhe askush nuk më ka pyetur për këtë veprim.

Abstenova për plotë arsyeje. Abstenova se fillimisht kriteret duhet të respektohen, kurse kritere nuk ka pasur!

Mandej kryetari e sqaroi se ka qenë vetëm kërkesa e Alketës, sepse ajo ishte e dalluar dhe kushtet i kishte tepër të rënda dhe njëkohësisht ishte rast i veçantë.

E treta diskriminim nuk duhet të ketë, sepse kemi edhe shumë studentë të tjerë nëpër shtetet e ndryshme. Mirëpo edhe ajo çka është më kryesore, ka shumë studentë të cilët studiojnë jashtë vendit, por i kanë kushtet shumë të mira i kanë prindërit të cilët janë të pasur, ata duhet t' i largojmë dhe t' ia lëshojmë vendin dikujt tjetër. Në këtë mënyrë duhet të bëhet një analizë e duhur për të parë se kush janë ata studentë, çfarë kushte kanë, për të pasur mundësi që të punojmë sa më realisht.

Sami Hoxha- unë kam qenë anëtarë i këtij Kuvendi, kur është marrë ky vendim fillimisht, por ndoshta është me interes që ta kemi një informatë më të kompletuar për pa e nënçmuar askënd, sepse këto vendime nuk i kemi marrë për inat të dikujt, por është një punë të cilën po e bëjmë në interes të qytetarëve tanë. Për këtë rast ka qenë një konkurrencë (para katër vite), kur në Komunë të Gjilanit janë zgjedh disa nxënës nga të gjitha shkollat (30 nga shkollat mesme) të cilët kanë mbajtur një kurs të gjuhës italiane dhe ka qenë aktivitet gjithëpërfshirës dhe nuk ka pasur dallime dhe prej të gjitha shkollave të Gjilanit kush ka qenë i interesuar kanë shkuar në atë kurs.

Prej atij numri të madh, të gjithë janë testuar, kurse të suksesshëm kanë dal 10 nxënës.

Nga kjo shihet se ka qenë një selektim shumë i rregullt në formë shumë profesionale dhe me dëshira personale. Mandej ka qenë një bashkëpunim institucional në mes të organeve komunale dhe të institucioneve të shtetit Italian. Ata e kanë ofruar këtë mundësi për ta stimuluar këtë ekip të mirë të nxënësve tanë dhe ne si Komunë ka qenë mangësi e jona nëse ne nuk do të ishim përgjigj në këtë aktivitet që ata e kanë ofruar për të mirën e fëmijëve tanë. Ky ka qenë një vendim i mirë dhe ky dallon prej atyre rasteve që ne kemi shumë e shumë të tjerë, por ky rast është specifik dhe si Komunë është për ta përfunduar dhe nuk duhet të tërhiqemi nga kjo, sepse ky është bashkëpunim ndërshtetëror.

Izmi Zeka- unë po propozoj që njëherë të merret vendim vetëm për Alketa Spahiun, pasi që ajo e ka përfunduar bachelorin dhe është duke e vazhduar masterin, prandaj të merret vendim për te, kurse për të tjerët të rikthehet në Komitetin për Arsim, të shikohet mundësia, pastaj të vijë në Kuvend.

Qemajl Mustafa- Alketa e ka përfunduar bachelorin para kohe vitin e kaluar dhe këtë vit është në vitin e parë në master. Te kjo vajzë nuk ka dilema, është me gjendje sociale jo të mirë, mandej është edhe studente shumë e mirë si edhe shumica prej tyre.

Ju keni të drejtë, sepse së paku një rast e di që në shtëpi i kanë 4 rroga dhe do të duhej të rikthemi për t' i rishqyrtuar.

Ky është rast specifik, prandaj duhet dalluar, sepse ne nuk kemi mundësi për ta ndihmuar çdo studentë që i vijon studimet master jashtë vendit. Ky ka qenë rast specifik, kur një komunitet katolik në Itali ka gjet fond për 3 mijë euro në muaj për secilin studentë. Ai komunitet na ka lut që a dëshironi që ju të dërgoni studentë në Itali me kusht që ju t' i financoni edhe për atë sa kanë propozuar ata.

Ky është rast i veçantë dhe ne po flasim për kontinuitetin e atyre fëmijëve.

Në të kundërtën ne një konkurs për bursa e kemi pasur para disa ditëve dhe e kanë pasur të drejtën për të konkurruar të gjithë ata që janë jashtë vendit. Mirëpo për ata që janë jashtë vendit bursa është pak më e lartë se këta që studiojnë në vend me kusht që komisioni i kualifikon sipas kritereve të cilat i kemi përcaktuar.

Ejup Haziri- disa herë është tërhequr vërejtja që mos të dalim jashtë rendit të ditës. Unë e di se po të ishte Alketa këtu, do të kishte heq dorë nga kërkesa që e ka bërë! Ne po i degradojmë kërkesat, sepse shumica e studentëve që janë atje unë i kam pasur nxënës dhe e di që janë të merituarit. Nëse e marrim dokumentacion e Alketës do të bindemi se ajo ka qenë studente e vitit. Ne po i ngatërrojmë gjërat, kërkesa ka qenë e pastër dhe për Alketën nuk kemi nevojë të mendohemi shumë dhe atë duhet motivuar për të ec përpara. Debatimi që u bë, prej fillimit e degradoam, sepse e kemi një kërkesë të Alketës shumë meritore dhe nuk kemi pasur nevojë ta zgjasim më tepër.

Izmi Zeka- unë propozoj që për Alketën të merret vendimi, kurse për të tjerët të kthehet në Komitetin për Arsim, të zbatohen procedurat dhe të analizohen të gjitha rastet.

Ju lutem të deklaroheni se kush është për ta miratuar kërkesën e Alketës?

Miratohet propozim –vendim 2.6: Ndarjen e bursave për master, për studentët që studiojnë në Itali (rasti i Alketa Spahiut), me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

Elisah Ymeri- ne kemi qenë të painformuar për këtë rast që ka qenë në vazhdimësi, prandaj doli jo mirë dhe pat të drejtë Ejupi që e tha që u degradoi vlera e këtyre studentëve me këto debate. Ne kemi qenë të painformuar se kjo ka qenë vazhdimësi e Kuvendit të kaluar.

Bahrie Veseli- nuk është askush kundër arsimit e sidomos kundër një vajze, prandaj unë e përgëzoj. Mirëpo nëse kjo vajzë është me nota të mira dhe është studente vitit, ka shumë mirënjohje dhe shumë shpërblime që i japin organizatat ndërkombëtare, prandaj më intereson sa do të jetë shuma e bursës që i epet nga Komuna dhe a e shfrytëzon ndonjë bursë tjetër kjo vajzë?

Qemajl Mustafa- në komitet le të vijë informacioni edhe për Alketën, por unë e di që me përfundimin e trevjeçarit, këta nuk kanë bursë nga ana italiane. Do të thotë këta fëmijë përveç ndihmës së Komunës duhet ta hulumtojnë edhe ndonjë burim tjetër.

Ju e dini se shpenzimet janë shumë të larta dhe nuk ia dalin me 6 mijë euro në vit.

2.7.Propozim vendimi për vazhdimin e mandatit anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në KRM “Higjiena”,

Izmi Zeka- këtë pikë e kemi debatuar në KPF, në të cilin komitet kemi kërkuar që t' i vazhdohet këtij komisioni mandati, por të cilët duhet të vijnë me një raport të punës të cilën e kanë bërë deri më tash.

Zijadin Maliqi- është vërtetë se Komisioni komunal e zgjedh komisionin e aksionarëve dhe kjo është e paraparë me nenin 5 pika 2 e Ligjit mbi ndërmarrjet publike. Mirëpo është e vërtetë edhe tjetra që në nenin 8 pika 2 e po atij ligji janë të obliguar që ata t' i japin raport KK-së për punën e vetë. Këta njerëz që janë në komision nuk i njeh askush si personalitete, mandej ata gjatë tërë mandatit, nuk janë paraqitur para këtij Kuvendi me raport të tyre. Në fillim të këtij muaji Komiteti për Shërbime Publike e ka pasur një raport nga ndërmarrja “Hidromorava” edhe raportin nga “Higjiena”. Megjithatë “Hidromorava” nuk është e obliguar për të dhënë raport, por mund ta jep një informatë, por ata e kanë dhënë raportin e kanë pasur përfaqësuesin e vet dhe janë sqaruar gjërat si duhet. Për Higjienën vetëm është dorëzuar një material dhe nuk ka ardhur askush për të dhënë sqarime dhe nuk kemi pasur njohuri se si të veprojmë?

Ne t' i vazhdojmë mandatin njerëzve të cilët kurrë nuk i kemi parë edhe pse ky Kuvend i ka emëruar, kjo është edhe shkelje e ligjit, por edhe ata e kanë shkelur ligjin.

Nëse ne ia vazhdojmë mandatin njerëzve që e shkelin ligjin atëherë ne edhe më tepër po gabojmë dhe për këtë arsye, grupi i jonë është kundër vazhdimit të mandatit këtij Komisioni.

Qemajl Mustafa- njëherë në vit me ligj, është e obliguar Higjiena të raportojë para Kuvendit dhe ka raportuar edhe Hidromorava. Ata kanë obligim dhe përsëri do të vijnë, por në anën tjetër ne kemi themeluar një komision prej 5 apo 7 anëtarëve të cilin e ka udhëheq Riad Rashti dhe ka qenë një kohë të gjatë në Higjienë në kontakt me Komisionin e aksionarëve, me Bordin, keni informacione dhe raport ka sjell ky komision disa herë. Ato informacione kanë ardhur prej atij komisioni dhe nuk kanë ardh ndryshe.

Po iu rikujtoj se është fjala që të mos lëmë vakum, sepse nuk guxojmë të lëmë vakum, për derisa ligji i ri është aprovuar dhe pret nënshkrimin Presidentes edhe derisa të mos fillojë së operuari ky PPP, mandej shumë shpejtë i votojmë të tjerët dhe vazhdojmë me punë.

Izmi Zeka- është në material deri në rikonstruimin e plotë të Kompanisë “Higjiena”, për mos të mbet një vakum institucional në këtë kompani. Ju lutem të deklaroheni se kush është për ?

Miratohet propozim-vendimi 2.7: Propozim vendimi për vazhdimin e mandatit anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në KRM “Higjiena, me 15 vota të anëtarëve të Kuvendit, 2 kundër, kurse të tjerët abstenuan.

Izmi Zeka - në KPF, kemi marrë vendim që komisioni për akte normative dhe komisioni i PPP-së, shuma e kompensimit për një seancë ka qenë 70 euro, kurse ne kemi rekomanduar që të zbritet në 40 euro për të dy këto komisionet.

Kush është që të zbritet shume e kompensimeve për një takim për të dy komisionet prej 70 euro në 40 euro, duke filluar nga kjo seancë e tutje.

Miratohet ky propozim i kryesuesit të Kuvendit me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit, që vlera e kompensimit të komisionit për akte normative dhe atij të PPP-së të zbritet nga 70 euro në 40 për çdo seancë.

Si propozim i dytë është ai kryetarit të Komunës, për mos ta njofto shitjen e ish marketit montazh të Ndërmarrjes “Promet”. Për këto raste materiale i posedoni, prandaj të deklaroheni për këtë vendim për mos shitje të këtij objekti?

Miratohet ky propozim me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

Të ndryshme

Arben Mehmeti- së pari do të jem konkretë, sepse e kemi dërguar një shkresë në adresë të juaj për çështje të heqjes së taksave të sigurimit, për shqiptarët e Luginës së Preshevës.

Propozojmë që kryetari në emër të KK të Gjilanit, t' i drejtohet Qeverisë me një kërkesë, për ta hequr këtë taksë.

Izmi Zeka- po e njoftoj Kuvendin se taksën e sigurimit e kemi zbritur dhe tash është 20 euro, por ne mund ta bëjmë edhe një kërkesë tjetër, mirëpo janë disa rregulla ndërkombëtare t' i cilat nuk lejojnë që ta heqim në tërësi. Kemi tendencë për ta zbritur edhe më tepër, por një taksë e vogël duhet të ekzistojë për shkak të disa normave ndërkombëtare.

Ne po e marrim për obligim që ta bëjmë një kërkesë së bashku me kryetarin, të cilin do t' ia përcjellim Kryeministrit.

Qemajl Mustafa- së pari t' iu njoftoj se këtë shqetësim e kanë ngrit afaristët tanë edhe më parë, atëherë kur ka qenë 60 euro e që ka qenë shumë e lartë. Mirëpo tash është zbritur në 1/3 do të thotë në 20 euro. Unë kam komunikuar me ministrin e Punëve të Brendshme atë Financave dhe kryeministrin, pas shqetësimeve që i kanë ngrit afaristët tanë. Pas këtij komunikimi dhe insistimi është bërë kjo ulje në 20 euro e cila përsëri është e lartë.

Ne mund ta bëjmë edhe një kërkesë, por duhet ditur se ne nuk bëjmë marketing me këtë çështje, sepse ky është komunikim i përhershëm i kryetarit të Komunës dhe i të tjerëve me Qeverinë. Unë kam qenë shumë këmbëngulës që të ndodhë dhe është tash 1/3.

Elisah Ymeri- unë në fillim të seancës e kam kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të na jep një sqarim lidhur me Lumin Banja?

Sami Azemi- gjithashtu edhe unë e kam një kërkesë për drejtorin e Shërbimeve Publike e cila është kërkesë e nënshkruar nga një numër i konsiderueshëm të banorëve të fshatit Pogragjë dhe fshatrave të tjera. Në këtë kërkesë bëhet fjalë për pengesat në rrugë të cilat gjenden në rrugën Gjilan- Pogragjë, por sidomos ndërmjet fshatit Malishevë dhe Pogragjë. Në mes këtyre fshatrave është një numër i madhe i pengesave (12), por edhe janë të vendosura pa kritere, janë shumë të larta dhe të pa shenjëzuara etj. Me këto pengesa ia kemi vështirësuar lëvizjen qytetarëve tanë.

Bahrie Veseli- unë është hera e tretë ose e katërtë që e kam ngrit zërin për një kërkesë e cila është debatuar edhe në grupin parlamentar e cila ka të bëjë me asfaltimin e rrugës “Gazmend Zajmi” e cila është nënshkruar edhe nga qytetarët. Disa ditë më parë kam biseduar edhe me kryetarin, por deri më sot nuk ka asnjë rezultat konkretë. Kërkoj që të merret në këtë drejtim diçka, sepse kjo lagjeje që 30 vjet është e urbanizuar, kurse kjo rrugë është e paasfaltuar.

Kërkesa tjetër urgjente është që në Lagjen e Tetë, rruga në drejtim të shkollës është një rrugë me shumë rreziqe për nxënësit dhe të tjerët, sepse nuk ka hapësirë për të kaluar dy automjete në drejtime të kundërta. Këtu duhet të bëhet një rrugë e re (shkëputje) në drejtim të shkollës, sepse ashtu ishte e planifikuar.

Mandej çështja e ndriçimit të rrugëve, shënjestimi i rrugëve dhe mirëmbajtja e qytetit e cila është duke ndodhur por mirëmbajtja tek Monumenti i Pavarësisë nuk është duke i mirëmbajtur ashtu si duhet, prandaj nuk duhet lënë në atë vend atë shëmti dhe sa më parë të ndërmerret diçka nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Gjithashtu edhe në lagjen “Arbëria” te Tregu i Kafshëve është një shëmti e tillë për të cilin rast është thënë se do të ketë përmirësime, por ende nuk ka lëvizur asgjë.

Sokol Haziri- ne në takimin e shefave të grupeve politike kemi biseduar për çështjen e komisionit të PPP-së. Në atë takim ne e kemi ngrit shqetësimin se në atë komision janë ngatërruar kompetencat e ekzekutivit dhe të them kushtimisht Kuvendit. Për këtë arsyeje do të ishte mirë që rregullorja të cilin e ka miratuar po ai komision t’ i bëjë disa ndryshime. Sidoqoftë ne si AAK, kemi një propozim të ri për këtë çështje për emrin e personit që është në atë komision dhe në vend timin (Sokol Haziri), AAK e dërgon Ibish Ibishin. Këtë propozim po e bëjë jo ndoshta për arsyen që e thash, por është mirë që të ndërmerren këta hapa dhe KPF mos të fuzionohet në një komision të tillë. Në fund çështja e propozimit tonë të mbetet, AAK në vend të Sokol Hazirit e dërgon Ibish Ibishin në komision e PPP-së.

Rashit Sahiti- kryetari i Komunës e ka pas dhënë një premtim për ta dërguar në Shqipëri, por ende nuk është përmbushur ai premtim, prandaj e lus kryetarin që ta realizoj këtë premtim!

Qemajl Mustafa- është një dallim kësaj herë, sepse nëse shkojmë, do të shkojmë me shpenzime personale. Ju kam premtuar dhe mund ta realizojmë dhe ju përcaktohet kur të dëshironi !

Arben Malqi- unë kësaj radhe e kam një kërkesë për një lagje te Tuneli e cila ishte e vetmja e paasfaltuar, në të cilën lagje jeton një person i cili është i hendikepuar dhe i cili lëviz me karrocë, prandaj është mirë që ta keni në konsideratë dhe së paku ta shtroni me zhavorr atë pjesë.

Izmi Zeka- të gjithë drejtorët të cilët i kanë marrë pyetje nga anëtarët e Kuvendit, përgjigjet brenda 7 dite ia dërgoni me shkrim. Ju falënderoj shumë dhe shihemi në seancën e radhës!

Seanca i përfundoi punimet në ora 13.45 min.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA